



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 15.04.2013

Nr. 0204-373

**PËR:** Ali Berisha, Kryetari i Komunës së Pejës  
Arbëresha Ajdini Nallbani, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Pejës

**LËNDA:** Vlerësimi i ligjshmërisë së Vendimit

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar vendimin nr. 463-248, lidhur me propozimin për këmbim të pronës së paluajtshme komunale me pronë private të z. Agim Morina, nga Peja, për realizimin e projektit me Interes Publik – për ndërtimin e fushave ndihmese stërvitore për stërvitjen e sportistëve të K.F. "Besa" Pejë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të vendimit ka konstatuar se:


- Bazuar në nenin 11 të Ligjit nr. 04 L-144, Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, komunat kanë të drejtë të bëjnë këmbimin e pronës komunale me persona fizik dhe juridik.
- Me rastin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me persona fizik dhe juridik, vlerësimin i pronave të cilat janë objekt i këmbimit, bëhet nga organi kompetent për vlerësim, ashtu siç është paraparë me paragrafin 6 të nenit 11 të Ligjit nr. 04 L-144, Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
- Vlerësimin e vlerës së tregut të pronave të paluajtshme që janë objekt i këmbimit e bën Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme, në kuadër të Ministrisë së Financave, ashtu siç është përcaktuar me ligjin përkatës për pronën e paluajtshme.

MAPL, bazuar në konstatimet e lartshënuara, kërkon nga autoritetet e komunës së Pejës, të ndërmarrin të gjitha veprimet ligjore për zbatimin e plotë të legjislacionit në fuqi, lidhur me këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe personave tjerë.

MAPL, është e përkushtuar të ofrojë përkrahje dhe ndihmën e nevojshme, për zbatimin e plotë të obligimeve që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**  
**Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,**



**Kopje:** *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL  
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së  
Arkivit të MAPL-së.*



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Dana: 18.04.2013

Br. 0204-373

**Za:** Ali Berisha, Gradonačelnik Opštine Peć  
Arbëresha Ajdini Nallbani, Prededavajuća Skupštine Opštine Peć

**Predmet:** Procena zakonitosti Odluke

Potovani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, je primilo Odluku br. 463-248, u vezi sa predlogom za razmenu nepokretne opštinske imovine sa privatnom imovinom Bakir Buri, iz Peći, za realizovanje projekta od javnog Interesa - za izgradnju pomoćnih terena za trenig FK Besa Peć.

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandator odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja odluke je konstatovalo:


- Na osnovu člana 11 Zakona br. 04 L-144, za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine, opštine imaju pravo da razmene opštinsku imovinu sa fizičkim i privatnim licima.
- Prilikom razmene nepokrtene opštinske imovine sa pravnim i fizičkim licima ,procena imovine koje su objekat razmene , se vrši od nadležnog organa za procenjivanje , Monako kako je predvidjeno sa paragrafom 6 člana 11 Zakona br. 04 L-144, za davanje na korišćenje i razmenu opštinske nepokretne imovine.
- Procenu tržišne cene nepokretnih imovina koje su objekt razmene vrši Kancelarija za procenjivanje nepokretne imovine,u sklopu Ministarstva Finansija, onako kako je odredjeno za dotičnim Zakonom za nepokretnu imovinu.

MALS, na osnovu gore nevedenih konstatacija,traži od autoriteta opštine Peć da preduzmu sve zakonske mere za potpuno sprovođenje zakonodavstva na snazi, u vezi sa razmenom nepokretne imovine opštine i drugih lica.

MALS, je opredeljeno da ponudi podršku i potrebnu pomoć, za potpuno sprovođenje obavaza koje proizilaze od sprovedljivog zakonodavstva za lokalnu samoupravu u Republiku Kosovo.

S poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**  
**Zamenik premijera i Ministar MALS-a,**



**Kopija:** *Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a*  
*Direktorima uprava MALS-a*  
*Arhivi MALS-a.*



Në bazë të nenit 11. Nenit 14. paragrafi 1. Dhe nenit 17. paragrafi 1. pika r) të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04.qershor 2008) dhe nenit 8. Dhe nenin 11. Paragrafit 1. të Statutit të Komunës së Pejës, 01.Numër: 09 – 8103 datë: 29.shtator 2008, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 06.Mars 2013, pas shqyrtimit të propozimit të Drejtorisë për Çështje Pronësore Juridike dhe Kryetarit të Komunës, për këmbim të pronës komunale me pronën private të pronarit z.Agim Morina,nga Peja, e me qëllim të realizimit të projektit për ndërtimin e fushave ndihmëse stërvitore për stërvitjen e futbollistëve të KF.”Besa” në Pejë, dhe në Rekomandim të Komitetit për Politikë e Financa, muar këtë

### V E N D I M

I. MIRATOHET Propozimi për këmbim pronash, dhe atë: të Ngast.kad.nr.7/1, në sipërfaqe prej 00.50,00 ha, që gjendet në f.Brestovik KK.Pejë, pronë e Komunës së Pejës, me Ngast.kad. nr.7/2, në sipërfaqe të njejt prej 00.50,00 ha, pronë private e z.Agim Morina, nga Peja, që gjendet gjithashtu në fshatin Brestovik KK.Pejë, në mes të pronës komunale, me vlerë të njejt, e me qëllim të realizimit të Projektit për ndërtimin e fushave ndihmëse stërvitore për stërvitjen e sportistvëve të K.F.”Besa” Pejë.

II. Për zbatimin e këtijë vendimi do të kujdeset Drejtoria për Çështje Pronësore Juridike e KK.Pejë.


III.Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal.

IV. Vendimi ti dërgohet: Drejtorisë për Çështje Pronësore Juridike të KK.Pejë, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal – Prishtinë, dhe një kopje i bashkangjitet Procesverbalit nga takimi i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me datë: 06. Mars 2013.

I.Numër: 463 - 248

Pejë, date: 06. Mars 2013.

KUVENDI KOMUNAL PEJË



KRYESUESJA,

Dr.Arbëresha Ajdini Nallbani